Ne e kemi realizuar angazhimin tonë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Angazhimeve të dhënies së Sigurisë 3000. Ky standard kërkon që ne të planifikojmë dhe të kryejmë proçedura në mënyrë që të arrijmë një nivel të arsyeshëm sigurie.

**Kriteret e Raportimit**

Si bazë të angazhimit të dhënies së sigurisë ne kemi përdorur:

- Ligjin Nr. 10091 datë. 05/03/2009 "Për Auditimin ligjor dhe organizimin e profesionit të kontabilistit";
- Ligjin Nr. 9901 datë 14/04/2008 " Për Shoqëritë Tregëtare".

**Përgjegjësitë e Drejtimit**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen në përputhje me kërkesat ligjore të: Projektit të Bashkimit (raportit të bashkimit), Marrëveshjes së Bashkimit, bilanceve kontabël të ndërmjetëm të shoqërive që

do shërbejnë për përllogaritjen e raporteve të këmbimit dhe atyre qe do të shërbejnë për bashkimin e aktiveve dhe pasive të dy shoqërive.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës të ndërmarrë në kohën e duhur të gjitha veprimet e nevojshme për të miratuar dhe autorizuar Marrëveshjen e Bashkimit dhe dokumentat e tjera që lidhen me të; të ndërmarrë çdo veprim për depozitimin e të gjitha dokumentave në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit për ti dhënë efekt bashkimit në datën efektive të saj; të përgatisë dhe të dorëzojë çdo aplikim tek autoriteti i Entit Rregullator të Energjisë me qëllim transferimin e Liçencës nga Shoqëria e Përthithur tek Shoqëria Përthithëse; të njoftojë të gjitha palët e interesuara që mund të preken nga proçesi i bashkimit. Në këtë kontekst drejtimi është përgjegjës për të diskutuar me Bankën Kombëtare Tregëtare dhe për të dhënë një zgjidhje në lidhje me Barrën Siguruese të aksioneve të shoqërisë " Hec Lanabregas" Sh.a. të cilat janë lënë peng për BKT-në. Drejtimi ka përgjegjësi që të garantojë se ka të gjithë fuqinë dhe autoritetin e kërkuar për të kryer veprimet dhe përpiluar dokumentat e bashkimit. Drejtimi ka përgjegjësinë të garantojë se nuk ka qënë përfshirë në ndonjë proçes falimentimi, shkrirje apo likuidimi.

**Përgjegjësitë e Ekspertit Kontabël të Regjistruar**

Përgjegjësia jonë është të rishikojmë Marrëveshjen e Bashkimit dhe të shprehim një opinion në lidhje me raportin e këmbimit të aksioneve, metodat e përdorura për të arritur në raportin e propozuar të këmbimit të aksioneve dhe në përshtatshmërinë e përdorimit të këtyre metodave.

**Përmbledhje e Punës së Kryer**

Ne kemi verifikuar dhe analizuar, projektin e bashkimit (raportin e bashkimit), marrëveshjen e bashkimit bilancet kontabël të ndërmjetëm që përbëjnë bazën e këtij raporti dhe raportin e këmbimit të aksioneve në mënyrë të tillë që të sigurohemi se këto materiale nuk përmbajnë keq deklarime materiale që do të ndikonin në realizimin e proçesit të bashkimit.

**Proçedurat tona përfshijnë sa më poshtë:**

- Rishikimin e marrëveshjes së bashkimit, raportit të bashkimit dhe bilancit kontabël pas përthithjes më 30 Shtator 2012;
- Rishikimin vendimeve të marra nga Këshilli Mbikqyrës që lidhen me bashkimin me përthithje;
- Analizën e metodës së përdorur në përllogaritjen e raportit të këmbimit të aksioneve.

**Në vijim të proçedurave të kryera ne konstatuam se:**

1. Ky bashkim po kryhet në kushtet e parcaktuara nga Neni 225 "Bashkimi me përthithje në Raste të Veçanta" i Ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare". Ky proçes është mbështetur në këtë nen të ligjit, për arsye se shoqëria Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a. zotëron 100 për qind të aksioneve të " Hec Lanabregas" Sh.a.

Adresa Rr. Pjetër Bogdani
Pall. 39/1 Ap.4/4
Tirana, Albania
Phone: (+355 4) 2222 889
Fax: (+355 4) 2222 889
email: t.gjini@gjiniconsulting.com

2. Në këto kushte bashkimi me përthithje ndërmjet këtyre shoqërive po kryhet pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sha, duke i miratuar vendimet e bashkimit në Këshillat Mbikqyrës të të dy shoqërive.
3. Në përputhje me Marrëveshjen e Bashkimit, në momentin e realizimit të bashkimit, Shoqëria Përthithëse do të marrë përsipër detyrimet dhe do të përfitojë aktivet dhe te drejtat e Shoqërisë së Përthithur.
4. Kapitali i shoqërisë Përthithëse pas bashkimit është i njëjtë me kapitalin e saj para bashkimit, pasi kapitali i shoqërisë së përthithur do të kompensohet me shumën e investimit **2,140,650 mijë Lekë**.
5. Bashkimi do të rezultojë në prishje të Shoqërisë së Përthithur pa kaluar në likuidim.

**Konkluzion**

Sipas opinionit tonë:

- Metoda e përdorur në përllogaritjen e raportit të këmbimit të aksioneve/kontributeve është Metoda e Vlerës Kontabël Neto. Kjo metodë ndryshon nga Vlera e Tregut pasi nuk merr në konsideratë rezultatet e ardhshme të shoqërive dhe sepse vlerat kontabël të shoqërive mund të ndryshojnë si pasojë e përdorimit të politikave të ndryshme kontabël të tilla si çmuarjet kontabël, kapitalizimi i aktiveve, rivleresimi i aktiveve, etj.
- Në kushtet kur Shoqëria Përthithëse zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë së Përthithur, dhe ky bashkim nuk cënon aksionerin e Shoqërisë së Perthithur, përdorimi i metodave të tjera në raport me metodën e përdorur nuk sjell asnjë impakt mbi përllogaritjen e raportit të këmbimit të aksioneve/kontributeve.
- Raporti i këmbimit të kontributeve është i drejtë dhe i arsyeshëm.

| | |
|---|---|
| **Emri i firmës së auditimit:** | **Gjini Consulting Shpk** |
| Datë: | 12 Dhjetor 2012 |

[signature]

Firma e Partnerit të Angazhimit

GJ GJINI CONSULTING Registered Auditors

Nr. 16868/1 Prot. Dt 29/10/2012

REPUBLIKA E SHQIPERISE VASIL N FYPE NOTER TIRANE

# PROJEKTI I MARRVESHJES SE BASHKIMI ME PERTHITHJE

Ndermjet

**Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a**
**Si Shoqeri Perthithese**

Dhe

**HEC Lanabregas sh.a**
**Si Shoqeri e Perthithur**

# PROJEKT MARREVESHJE PER BASHKIMIN E SHOQERIVE

Sot, me date 28.10.2012, ne Tirane, palet e meposhtme lidhin kete marreveshje per bashkimin e shoqerive

("Marreveshja"):

- Ujesjelles Kanalizime Tirane sha shoqeri anonime me kapital te rregjistruar prej 2,544,398,000 leke i ndare ne 2,572,398 aksione me vlere nominale 1000 leke/aksion, teresisht i paguar me kontribute ne natyre, me adrese te rregjistruar ne Rruga 5 Maji, Prane Medresese, Tirane është krijuar me vendimin e gjyaktës Tiranë nr. 24875 date 28.12.2000,e perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithsem i shoqerise z. Sahit Dollapi, per qellim te kesaj marrveshje Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a do te quhet " Shoqeria Perthithese" , dhe

- HEC Lanabregas sh.a shoqeri anonime me kapital te rregjistruar prej 241,117,000 lekeindare ne 241,117 aksione me vlere nominale 1000 leke/aksion, teresisht i paguar, me adrese te rregjistruar ne Lanabregas Komuna Dajt,Tirane; rregjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit Tirane ne 07/09/2011, e perfaqesuar nga administratori ligjor i shoqerise z. Alban Çatalli, per qellim te kesaj marrveshje HEC Lanabregas sh.a do te quhet " Shoqeria e Perthithur"

## MEQENESE

A. Drejtuesit e Shoqerise se Perthithur dhe Shoqerise Perthithese konsiderojne se eshte ne interesin e te dyja paleve qe shoqerite te bashkohen ne nje shoqeri te vetme sic rezulton edhe nga raporti mbi projektin e marreveshjes per bashkimin e Shoqerive;

B. Shoqeria Ujesjelles Kanalizime sh.a bazuar ne kontraten nr 1588 rep –nr 320 kol date 08/05/2012 " Për Blerjen e Aksioneve të HEC Lanabregas sh.a ", eshte zoteruese ne masen 100% te kapitalit te Shoqerise Hec Lanabregas sh.a, nje shoqeri e themeluar ne 07/09/2011 si rezultat i nje operacioni spin –off te aktiveve te prodhimit te energjise elektrike te Korporates Elektroenergjitike Shqiptare sh.a te perdorura prej saj, ne vendndodhjen Lanabregas, Komuna Dajt Tirane.

C. Me qellim permiresimin e performances ekonomike te Shoqerise Ujesjelles Kanalizime Sha si pasoje e uljes te ndjeshme te shpenzimeve per furnizim me energji elektrike dhe ne perputhje me objektivat e Shoqerise per furnizimin e popullsise me uje te pijshem 24 ore dhe me tarifa sa me te favorshme per konsumatoret fundore, duke siguruar realizimin e permiresimit te sherbimit ndaj klienteve, ofrimin i nje impakti pozitiv ne komunitet, rritje te marzheve te fitimit, te cilat permiresojne flukset e parase dhe rritjen e investimeve ne infrastrukturen prodhuese.

D. Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a dhe HEC Lanabregas sh.a deshirojne te kryejne nje Bashkim nepermjet te cilit Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a do te perthithe shoqerine HEC Lanabregas sh.a dhe shoqeria Ujesjelles Kanalizime sh.a do te vazhdoje aktivitetin kurse HEC Lanabregas sh.a do te prishet pa kaluar ne likujdim.

E. Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a bazuar ne kerkesat e Ligjit Nr 10296 date 08.07.2010 " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 23 i Statutit të Shoqërise, ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Shoqerite Tregtare", Pjesa IX , Neni 215 Perkufizimi , paragrafi 1, Neni 216 Marrveshja dhe raporti i bashkimit Neni 217 Raporti i Ekperteve, dhe Neni 225 "Bashkimi me perthithje ne Raste te Vecanta", propozoi per Bashkimin me perthithje te Shoqerise HEC Lanabregas Sh.a ne Ujesjelles Kanalizime sh.a Tirane.

F. Me date 27.08.2012 propozimi i mesipem u diskutua nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise Ujesjelles Kanalizime sh.a Tirane ku u vendos: Miratimi i fillimit te procedurave per bashkimin nepermjet perthithjes, te shoqerise HEC Lanabregas sh.a nga Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a dhe u ngarkua Administratori i shoqerise qe te hartoje projekt Marrveshjen e Bashkimit, si dhe te gjithe dokumentacionin perkates per kete operacion.

G. Me date 17.09.2012 nga Keshilli Mbikqyres i Shoqerise Ujesjelles Kanalizime Tirane Sh.a dhe u vendos: Miratimi i Ekspertit Kontabel "Gjini Consulting", per vleresimin e kushteve te projektit te Marrveshjes dhe pergatitjen e Raportit te bashkimit nepermjet perthithjes te shoqerise HEC Lanabregas Sha nga Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Tirane Sha.

H. Me date 30.10.2012 u mblodh Keshilli Mbikqyres i Shoqerise Ujesjelles Kanalizime sh.a Tirane dhe vendosi: Autorizimin e Drejtorit te Pergjithshem te Shoqerise, per nenshkrimin e Projekt-Marrveshjesse Bashkimit nepermjet Perthithjes, te shoqerise Hec Lanabregas Sha nga Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Tirane Sha.

Palet kane rene dakort per te hartuar kete marrveshje ne menyre qe te percaktojne afatet dhe kushtet e te drejtave dhe te detyrimeve respektive ne perputhje me Transaksionin e Bashkimitsi me poshte vijon:

## 1. PERKUFIZIME DHE INTERPRETIME

Ne kete Marrveshje, pervecse kur kuptohet ndryshe ose kur cilesohet ndryshe me tej, fjalet e meposhtme do te kene kuptimet si vijon:

- **"Marrveshje"** nenkupton kete marrveshje
- **"Shoqeri Perthithese"** ne kete Marrveshje do te thote shoqeria Ujesjellës Kanalizime Tiranë Sha.
- **"Shoqeri e Perthithur"** ne kete Marrveshje do te thote shoqeria HEC Lanabregas sh.a.

- **"Enti Rregullator i Energjise"** ERE eshte person juridik publik, sikurse pershkruhet ne ligjin nr. 9072, date 22.05.2003 Per sektorin e energjise elektrike i ndryshuar.

- **"Informacion konfidencial"** nenkupton cdo informacion, me shkrim ose me goje ne lidhje me aktivitetin financiar ose aktivitete te tjera te shoqerive Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a dhe HEC Lanabregas sh.a

- **"Qenda Kombetare e Rregjistrimit "** nenkupton Njesine Administrative te themeluar ne baze te ligjit nr.9723,date 03/04/2007,"Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit".

- **"Licensa"** do te thote e drejte qe jepet nga Enti Rregullator i Energjise me Vendim per Prodhim dhe shitje te energjise elektrike.

- **"Data e nenshkrimit "** nenkupton daten e nenshkrimit te kesaj Marrveshje nga te dy palet, ashtu sic tregohet ne faqet e nenshkruara te kesaj Marrveshje.

## 2. OBJEKTI I MARREVESHJES

2.1. Palet bien dakort qe ne perputhje me kushtet e kessaj marreveshje, HEC Lanabregas Sh.a do te bashkohet me Shoqerine Ujesjellës Kanalizime Tiranë Sh.a, duke u perthithur nga kjo e fundit ne Daten e Mbylljes se operacionit te bashkimit.

2.2. Shoqeria Ujesjellës Kanalizime Tiranë Sh.a do te jete Shoqeria Perthithese dhe do te vazhdoje veprimtarine e saj sipas legjislacionit ne fuqi. Emri i Shoqerise Perthithese do te mbetet Ujesjellës Kanalizime Tiranë Sh.a.

## 3. BASHKIMI, KEMBIMI I AKSIONEVE

3.1. HEC Lanabregas Sh.a do t'i trasferoje shoqerise UKT Sh.a teresine e elementeve te aktivit e te pasivit duke perfshire edhe ato qe rezultojne nga operacionet e kryera gjate periudhes ushtrimore deri ne Daten Efektive te Mbylljes, ne kembim te kuotave te kapitalit te Shoqerise Perthithese ne favor te ortakeve te Shoqerise se Perthithur.

3.2. Operacioni i bashkimit te shoqerive nuk prodhon raporte kembimi te aksioneve ndermjet shoqerise perthithese dhe asaj te perthithur pasi shoqeria perthithese zoteron 100% te aksioneve te shoqerise se perthithur. Nga ky operacion nuk clirohet asnje shuma si primit i bashkimit.

3.3. Si rezultat i operacionit te Bashkimit, Kapitali aksioner i shoqerise Ujesjellës Kanalizime Tiranë sh.a ne Daten Efektive te mbylljes mbetet i njejte me kapitalin para bashkimit. Kapitali aksioner i shoqerise Hec Lanabregas sh.a netohet ne bilancin e konsolidur te te dy shoqerive me vleren e pjesmarrjes dhe diferenca midis tyre kalon si Emer i Mire ne bilancin e konsolidur ne date 30.09.2012.

3.4. Metoda e perdorur ne perllogaritjen e raportit te kembimit te aksioneve/kontributeve eshte Metoda e Vleres Kontabel Neto. Kjo metode ndryshon nga Vlera e Tregut pasi nuk merr ne konsiderate rezultatet e ardhshme te shoqerive dhe sepse vlerat kontabel e shoqerive mund te ndryshojne si pasoje e perdorimit te politikave te ndryshme kontabel te tilla si emuarjet kontabel, kapitalizimi i aktiveve, rivleresimi i aktiveve, etj. Megjithate, ne kushtet kur Shoqeria Perthithese zoteron 100% te aksioneve te Shoqerise se Perthithur, perdorimi i metodave te tjera ne raport me metoden e perdorur nuk sjell asnje impakt mbi perllogaritjen e raportit te kembimit te aksioneve/kontributeve.

3.5. Ky operacion bashkimi nuk do te permbaje as te drejta dhe as ndonje avantazh te vecante.

## 4. DREJTIMI I SHOQERISE PAS BASHKIMIT

4.1. Vetem Anetaret e Organeve drejtuese te Shoqerise Perthithese do te vazhdojne detyren dhe funksionin e tyre pas realizimit te bashkimit si drejtues te Shoqerise Perthithese.

4.2. Statuti i Shoqerise Ujesjellës Kanalizime Tiranë Sh.a, do te vazhdoj te jete edhe Statuti i Shoqerise Perthithese.

## 5. DATA E BASHKIMIT

5.1. Ne aspektin e kontabilitetit te gjitha operacionet e veprimtarise te kryera prej shoqerise "HEC Lanabregas" sha nga data 1 janar 2013 deri ne daten e regjistrimit prane QKR te procesit te bashkimit, do te konsiderohen si te kryera nga shoqeria perthithese "UKT" Sh.a. dhe rregjistrimet kontabel perkatese do te merren ne librat e saj.

5.2. Duke qene se data efektive eshte data 1 Janar 2013 bilanci perfundimtar perthithjes se do te jete bilanci i konsoliduar i te dy shoqerive i dates 31.12.2012.

5.3. Llogarite qe jane perdorur per te percaktuar kushtet financiare te bashkimit, jane hartuar duke u referuar dates 30.09.2012, si per shoqerine perthithese ashtu edhe per shoqerine e perthithur.

## 6. EFEKTET E BASHKIMIT

Shoqeria perthithese si efekt i bashkimit duhet te kryeje keto veprime:

6.1. ShoqeriaPerthitheseduhettetransferojenga ERE Licensen "Per prodhimindheshitjen e energjise" ne perputhje me ligjin nr. 9072, date 22.05.2003 "Per sektorin e energjise elektrike" i ndryshuar license te cilenaktualisht e zotronShoqeria e Perthithur ne perputhje me Vendimin e ERE Nr.134 date 06.12.2011.

6.2. Shoqeria Perthithese duhet te njoftoj ne lidhje me kete marrveshje Banken Kombetare Tregetare duke qene se Aksionet e Shoqerise se Perthithur jane barre siguruese per llogari te kesaj Banke.

6.3. Duhet te realizoje mbylljen e NIPT te shoqerise se perthithur dhe transferimit e detyrimeve tatimore tek shoqeria perthithese.

6.4. Transferimi i shoqerise se Perthithur tek Shoqeria Perthithese nuk do te sjelle asnje pasoje kundrejt punemarresve te shoqerive dhe asnje zgjidhje te kontratave te punes nuk do te rezultoje.

## 7. PREMTIME DERI NE MBYLLJE

Deri ne daten e mbylljes,Palet duhet qe:

7.1. Te ndermarrin te gjitha veprimet e nevojshme per te miratuar dhe autorizuar kete Marrveshje si dhe dokumentat e tjera ne lidhje me to.

7.2. Te ndermarrin cdo veprim per depozitim te te gjitha dokumentave ne Qendern Kombetare te Rregjistrimit per ti dhene efekt Bashkimit ne Daten Efektive.

7.3. Te pergatisin dhe te dorezojne cdo aplikim tek autoriteti i ERE me qellim marrjen e Licenses nga Shoqeria Perthithese.

7.4. Te Autorizojne Znj. Valbona Saraçini me detyre juriste dhe Znj. Ilda Çelmeta me deryre juriste, te kryeje te gjitha veprimet prane te gjitha organeve kompetente administrative qe jane te nevojshme per realizimin e procesit te bashkimit.

## 8. MBYLLJA E OPERACIONIT TE BASHKIMIT

8.1. Bashkimi do te behet efektiv ne diten e depozitimit prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te asambleve se ortakeve te shoqerive pjesemarrese ne bashkim mbi miratimin e bashkimit.

8.2. Me realizimin e bashkimit Shoqeria Perthithese do te marre persiper detyrimet dhe do te perfitoje aktivet dhe te drejtat e Shoqerise se Perthithur duke filluar nga 1 Janar 2013.

## 9. DEKLARIMET DHE GARANCITE

9.2. Deklarimet dhe Garancite e Ujesjelles Kanalizime Tirane Sha:

a) Ujesjelles Kanalizime Tirane Sh.a dhe perfaqesuesi i saj ka te gjithe fuqine dhe autoritetin e kerkuar per te kryer kete Marrveshje dhe cdo dokument tjeter qe duhet kryer ne perputhje me kete te fundit.

b) UKT dhe as ndonje nga aksioneret e tij nuk kane qene te perfshire ne nje proces falimentimi (apo procese te tjera te ngjashme), ne shkrirjeose ne proces likujdimi.

9.3. Deklarimet dhe Garancite e Hec Lanabregas sh.a:

a) Hec Lanabregas sh.a dhe perfaqesuesi i saj ka te gjithe fuqine dhe autoritetin e kerkuar per te kryer kete Marrveshje dhe cdo dokument tjeter qe duhet kryer ne perputhje me kete te fundit.

b) Hec Lanabregas sh.a nuk ka qene e perfshire ne nje proces falimentimi (apo procese te tjera te ngjashme), ne shkrirje ose ne proces likujdimi.

**10. ZGJIDHJA E MARREVESHJES**

10.1. Kjo Marrveshje mund te perfundoje ne cdo kohe para Dates se Mbylljes vetem me aprovimin me shkrim te te dyja paleve.

10.2. Cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve ne lidhje me zbatimin e kesaj Marreveshje qe nuk mund te zgjidhet me mirekuptim midis tyre, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimet e se ciles mund te nkimohen sipas dispozitaveteKodit te Procedures Civile.

**11. KONFIDENCIALITETI**

11.1. Palet do te trajtojne ne menyre konfidenciale te gjitha informacionet e marra dhe te perftuara si rezultat I nisjes dhe permbushjes se kesaj Marrveshje, te cilat kane lidhje me negociatat, permbushjen dhe mbylljen e kesaj Marrveshje ose te cdo do komenti qe referohet nga kjo marrveshje.

11.2. Palet mund te japin informacion nje pale te trete, I cili mund te konsiderohet konfidencial nese :

a) Kerkohet nga ligji ose me qellim te ndonje procedure ligjore

b) Kerkohet nga ndonje institucion qeveritar

c) Me miratimin parapark me shkrim te pales tjeter.

**12. LIGJI I ZBATUESHEM**

Per sa nuk parashikohet ne kete Marreveshje do te zbatohet legjislacioni ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, i aplikueshem per kete Marreveshje.

**13. TE NDRYSHME**

13.1. Te gjitha komunikimet, njoftimet dhe shpalljet e kerkuara apo dhe te lejuara nga kjo Marrveshje do te dorzohen dorazi ose me ane te postes ne adresen si me poshte vijon, derisa Palet te njoftojne njeri-tjeterin per ndryshime te adresave te tyre.

| | |
|---|---|
| **Shoqeria** | **Shoqeria** |
| **Ujesjelles Kanalizime Tirane Sha** | **HEC Lanabregas Sha** |
| Ujesjelles Kanalizime Tirane | Hec Lanabregas, |

Rruga 5 Maji, Prane Medresese, Tirane

Lanabregas Komuna Dajt, Tirane

13.2. Kjo Marreveshje e perpiluar dhe neshkruar ne 10 (dhjete) kopje ne gjuhen shqipe, perben marreveshjen e plote midis paleve, premtimet, deklarimet, garanci te dhe marreveshjet ne lidhje me objektin e kesaj marreveshje. Cdo ndryshimi kesaj Marreveshje do te jete I vlefshem vetem nese behet me miratim me shkrim te paleve I nenshkruar nga perfaqesuesit e tyre te autorizuar.

**Shoqeria**
**Ujesjelles Kanalizime Tirane Sha**
Perfaqesuar nga

**Ing. Sahit Dollapi**
**Drejtori i Pergjithshem**

**Shoqeria**
**HEC Lanabregas Sha**
Perfaqesuar nga

**Ing. Alban Çatalli**
**Administrator**


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

mbiemri/surname
Dollapi
emri/given name
Sahit
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Tropoje
datëlindja/date of birth
05-06-1962
data e lëshimit/date of issue
24-09-2009
autoriteti lëshues/authority
MB
nr. letërnjoftimi/card no.
027619803
gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
23-09-2019
nr. personal/personal no.
G20605231T
ALB
firma/signature


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

mbiemri/surname
Çatalli
emri/given name
Alban
shtetësia/nationality
Shqiptare/Albanian
vendlindja/place of birth
Tirane
datëlindja/date of birth
17-06-1983
data e lëshimit/date of issue
29-09-2009
autoriteti lëshues/authority
MB
nr. letërnjoftimi/card no.
027650712
gjinia/sex
M
data e skadimit/date of expiry
28-09-2019
nr. personal/personal no.
I30617076E
ALB
firma/signature

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**
**NOTER: VASIL FYPE**
**Studio: Rruga e "DIBRES", Pall. 335**
**Tel. 04/2224207/Mob. 0682222143**

*Takse e paguar*

Nr. 8047 Rep.

Nr. 2048 Kol.

## VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot ne daten 11/12/2012 (Dymijedymbedhjete), dite e Marte, perpara meje Noterit **Vasil N. FYPE**, u paraqiten personalisht:

**1) Z. SAHIT DOLLAPI,** i biri i Shefqet-it, lindur me 05/06/1962 ne Tropoje, banues ne Tirane, Rruga "Zonja Çurre", Nr. 48, mbajtes i Leternjoftimit (ID) me Nr. 027619803, ne cilesine e **Drejtorit te Pergjithshem te Ujesjelles Kanalizime Tirane – Sh. A.**

**2) Z. ALBAN ÇATALLI,** i biri i Arjan-it, lindur me 17/06/1983 ne Tirane, banues ne Tirane, Rruga "4 Deshmoret", mbajtes i Leternjoftimit (ID) me Nr. 027650712 ne **Cilesine Administratorit te HEC- Lanabregas Sh.A**.

Te Interesuarit e paraqitur jane madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar.

Te Interesuarit, me vullnet te lire e te plote, **me deklaruan se kane perpiluar jashte kesaj Zyre Noteriale nje Projekt Marreveshje per Bashkimin e Shoqerive (Me Perthithje) me daten 28/10/2012. Palet e ketij Projekti me deklarojne se edhe e kane nenshkruar kete Projekt po jashte kesaj Zyre dhe pranojne ta demontrojne kete Nenshkrim edhe ne pranine time.**

Une noteri, pasi u sigurova per identitetin e tyre, u binda per vullnetin e deklarimit te tyre te lire e te plote dhe ne baze te Neneve 216 e 225 te Ligjit 9901, date 14/04/2008 "Per Shoqerite Tregtare", te Nenit 39 (pika h) te Ligjit Nr. 7829, date 01/06/1994 "Per Noterine", vertetoj nenshkrimin e tyre ne baze te Ligjit.

**NOTER**
**VASIL N. FYPE**

**ASAMBLEA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE**
**E SHOQËRISË "UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË" SHA**

---

**VENDIM**

**Nr. 1 Datë 16 / 01 /2013**

**Për**
**Miratimin e Marreveshjes se Bashkimit dhe Raportit te Eksperteve per bashkimin me perthithje te Shoqerise HEC Lanabregas sh.a nga shoqeria Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a**

Në mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenet 135 218 dhe 220, Asamblea e Pergjithshme e Aksionereve të shoqerise Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a,

**VENDOSI:**

1.Miratimin e Marreveshjes se Bashkimit dhe Raportit te Eksperteve per bashkimin me perthithje te Shoqerise HEC Lanabregas sh.a nga shoqeria Ujesjelles Kanalizime Tirane sh.a, pas fazes se publikimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

3.Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

**ASAMBLEA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE**

**Bashkia Tiranë**
Z.Lulzim Basha ____________

**Bashkia Kamëz**
Z.Xhelal Mziu ____________

**Bashkia Vorë**
Z.Lulzim Vrana ____________

**Komuna Paskuqan**
Z.Petrit Neziraj ____________

**Komuna Farkë**
Z.Fatbardh Plaku ____________

**Komuna Dajt**
Z.Besim Bastari ____________

**Komuna Kashar**
Z.Shaban Sorra

**Komuna Shëngjergj**
Z. Bedri Ruci

**Komuna Petrelë**
Z.Ylli Kupi

**Komuna Bërxullë**
Z.Ndue Bushpepa

**Komuna Bërzhitë**
Z.Genc Drita

**Komuna Krrabë**
Z.Artan Leka

**Komuna Baldushk**
Z.Alban Berisha

**Komuna Zall-Herr**
Z.Gëzim Lila

**Komuna Prezë**
Z.Ibrahim Kurti

**Komuna Vaqarr**
~~Z.Ylli Imeri~~